



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 4, 5 paragrafi 2 dhe neni 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën **27 prill 2023**, merr këtë:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

1. Me këtë vendim znj. Adea Badivuku, studente e doktoraturës në piano, i ofrohet përkrahje financiare në shumë prej tremijë euro (3,000.00 €) për realizim të projektit me karakter ndërkombëtar, për promovim dhe avancim të kulturës dhe artit në Kosovë që do të realizohet nga data 22-28 qershor 2023 në Prishtinë.
2. Mjetet financiare të cekur në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Përfituesi mjeteve financiare nga pika 1 e këtij vendimi duhet të dorëzoj në komunë – Drejtorinë për Buxhet dhe Financa brenda 7 ditësh pas përfundimit të projektit raport kthyes për shfrytëzimin e subvencionit,
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 101/23

Nr. i fq. / Br. s: -1-

Data / Datum 27.04.2023

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 prill 2023**, merr këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIM TË VENDIMIT

1.Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si në vijim:

1.1 Në paragrafin 1, pika 1.3 z.Dardan Abazi, Drejtor i DKA-së, caktohet anëtar i KKSB-së.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit